

Engjëllushe KARAJ

**NDAJFOLJET NË “FJALORIN E GJUHËS SHQIPE”
TË ALEKSANDËR XHUVANIT - FORMIMET ME
PREJARDHJE**

Pasuria leksikore e “Fjalorit të gjuhës shqipe” të Aleksandër Xhuvanit ka vend, peshë e rëndësi të madhe në leksikun e shqipes në përgjithësi, por dhe për të sipërmarrë studime nga më të ndryshmet dhe me interes gjuhësor, kulturor etj.

Një pjesë e rëndësishme e kësaj pasurie janë edhe ndajfoljet. Nga 17 000 lema që “Fjalori” ka në makrostrukturën e tij (nuk po ndalemi te frazeologjia), ndajfolje numërohen rreth 1100.

Në këtë punim do të përpiqemi të japim një pasqyrë të ndajfoljeve në këtë “Fjalori” dhe kryesisht të atyre të formuara me prapashtesa. Ky numër është afërsisht i njëjtë me atë të “Fjalorit të gjuhës shqipe”, 1954, që sipas prof. Enver Hysës numëron afërsisht rreth 1200 fjalë të shënuara si ndajfolje, duke përfshirë në këtë numër deri variantet dialektore që pasqyrohen në atë fjalor¹.

Në numrin e ndajfoljeve në “Fjalorin” e Xhuvanit kemi përfshirë ndajfoljet si fjalë titull, edhe kur thuhet “edhe si *ndajf.* apo *lokuc. ndajf.*”. Por nuk janë përfshirë ndajfoljet e përdorura në shpjegime, në shembuj, çka nënkupton se numri i tyre është shumë më i madh.

Për nga formimi, ndajfoljet ndahen në fjalë të parme, të prejardhura, të përngjitura dhe lokucione.

¹ E. Hysa, “Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe”, *Studime filologjike*, 1970/3, f. 63.

Ndajfoljet e parme në “Fjalorin” e Xhuvanit janë të shumta: *mirë, para, pas, prapë, sa, sot, shkurt, shumë, tani, tash, tej, tek, tesh, troç, tutje, thjesht* etj.

Ndajfoljet e përngjitura në “Fjalor” janë të shumta: *përnjëherë, përsëprapi, pjetposhtë, qëmoti, qëparthi, qyshkur, rrokapjekthi, sado, symbyllëtas, symbyllthi, syrambyllas, syrambyllazi, syrambyllthi, tekdo, teksa, tevonashi, tërëmonë, tërënjë, tërëvit, tjetërkund* etj.

Lokucione ndajfoljore: *arna-arna, arnë mbi arnë* (arbërisht), *bllunga bllunga, rreth e rreth, palë-palë, fill’e flakë, goja gojës, majë më majë, sa ora, pikë më pikë, rreth e qark, rreth e përçark, va pa va, zdruq-zdruq, varg e vistër* etj.

Ndajfoljet e prejardhura: me konversion (ndajfoljezimi i emrave, foljeve, mbiemrave etj.): *lak, lemeri, pas, plumb, rreth, rryp, sqokë, trung, trup, turr, ujë, urt, varg, vrap*.

Në grupin e ndajfoljeve të prejardhura vendin më të madh e zënë ato të formuara me prapashtesim. Prof. E. Hysa shprehet se “Megjithëse prapashtesat që formojnë ndajfolje janë relativisht të pakta në numër, prapashtesëzimi është shumë produktiv në kategorinë e ndajfoljeve, ku dallohen si më produktive prapashtesa *-(i)sht*, po dhe *-as (-azi) e -thi*.”²

Me të drejtë prof. E. Hysa thotë se “... tipi që ka një përhapje të gjerë dhe që ka krijuar një radhë të tërë ndajfoljesh të reja është tipi me prapashtesë.”³

Në formimet me prapashtesa më të shumta janë ato me:

Prapashtesa *-as/azi*

“Sipas shkallës së pasqyritit ndër fjalorët kryesorë të shqipes, klasa e ndajfoljeve me prapashtesën *-as/-azi* ka shënuar një rritje ritmike: te “Fjalori shqip-greqisht” i K. Kristoforidhit janë përfshirë 31 ndajfolje të këtij tipi (5% e të gjitha ndajfoljeve në të), te “Fjalori i gjuhës shqipe” 22 (10%) dhe te

² E. Hysa, “Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe”, *Studime filologjike*, 1970/3, f. 63.

³ E. Hysa, “Formime ndajfoljore me prapashtesa në shqipen e sotme letrare”, *Studime filologjike*, 1970/1, f. 111.

“Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 290 (15%).”⁴ Te “Fjalori” i Xhuvanit, me gjithë variantet numërohen 155.

Prapashtesa *-as/-azi* bashkohet:

1. Me tema emërore të thjeshta: *bishtas, brinjazi, burras, grykas, gjelas, hundazi, krushkazi, plumbazi, radhazi* etj.

2. Me tema mbiemërore: *fshehtazi, ftoftas, lashtazi, qetazi, thatas, thjeshtazi* etj.

3. Me tema ndajfoljore: *këtejazi, largas e lagazi, lartazi, ngushtazi, rrallas, thjeshtas e thjeshtazi* etj.

4. Me tema foljore: *fshehtazi, hedhazi, kapërxyerazi, këmbyerazi, mbytazi, ndarazi, ratas, rrëshqitas, vjedhaz e vjedhazi* etj.

A. Xhuvani e E. Çabej, edhe E. Hysa pranojnë një prapashtesë *-as* me variantet *-azi, -az, -azë, -aza*.⁵

Ne kemi gjetur dhe variantin e ndajshtesës *-(ë)za*: *dëngëza, faqeza, fshatëza, gjunjëza(j), njimenëza, pupëza, rrëmbëza, rrënjëza, vickëza, vingëza*.

Këto prapashtesa dalin në këto shifra në *Fjalor*:

-as/-azi – 80 dhe 53

-aza/- azë – 3 dhe 4

-za /-zaj – 9 dhe 6

Më poshtë po japim disa shembuj me këto variante:

me *-zaj*: *húndëzaj, kasnjëditëzaj, mënjëzaj, njëditëzaj, njënatëzaj, përsënjëzaj*

me *-aza*: *bukuraza, huaza, uhaza*

me *-(a)zë*: *cazë (më), cazë, laraskazë, sazë*

me *-az*: *larakaz, mbyllasymaz, ungjaz*

Prapashtesa *-(i)sht*

“Fjalor shqip-greqisht” (1904) i K. Kristoforidhit ka 45 ndajfolje me *-isht* (8% të të gjitha ndajfoljeve që përfshin), “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954) 191 (17%) dhe “Fjalori i gjuhës

⁴ J. Thomai, “Ndajfoljet me prapashtesën *-as/-azi* në gjuhën shqipe”, *Studime për gjuhën shqipe, III, Semantika leksikore*, f. 194.

⁵ E. Hysa, “Ndajfoljet në gjuhën shqipe”, *Studime filologjike*, 1970/3, f. 51-52.

së sotme shqipe” (1980) 307 (15%)”.⁶ “Fjalori” i Xhuvanit ka 98 ndajfolje me këtë prapashtesë, ndër të cilat kemi:

a. **15 lema** p.sh. *bagëtisht, dashtënisht e dashurisht, flakurisht, grarisht, katundisht, lartësisht, liksht, lisht, lopërisht, nevojisht, plotësisht, rrëmisht, rrmisht, shoqërisht, zotnisht.*

b. **19 raste të përdorura në shembuj**, p.sh.: *burrnisht, gjermanisht, huarisht, jashtëzakonisht, lirisht, mjerisht, mjeshhtërisht, moralisht, natyrisht, pikrisht, praktikisht, rregullisht, shpirtërisht, tmerrisht, trimënisht, udobisht, urtisht, vazhdimisht, zakonisht.*

c. Janë dhe 64 raste ku ky tip formimi **është përdorur në shpjegime**, p.sh.: *absolutisht, analogjikisht, arabisht, arbërisht, botërisht, bujarisht, burrërisht, ekonomikisht, etimologjikisht, figurisht, fizikisht, frëngjisht, gabimisht, gegërisht, gegërisht, gjasësisht, gjasësisht, gradualisht, hollësisht, horizontalisht e orizontalisht, italisht, krejtësisht, kryesisht, kulmorisht, kuptimisht, legjitimisht, mesatarisht, metaforikisht, metaforisht, mjerisht, moralisht, negativisht, njëkohësisht, normalisht, paralelisht, përfaqësisht, përgjithësisht, përkatësisht, përkohësisht, persisht, pikërisht e pikrisht, pjesërisht, plotësisht, posaçërisht, qëllimisht, qetësisht, qorriht, rastësisht, reciprokisht, rregullisht, rumanisht, seriozisht, shkodranisht, shpirtërisht, sistematikisht, slavisht, tërësisht, toskërisht, turqish, veçanërisht, verbalisht, verbërisht, vertikalisht, zakonisht.*

Një grup i rëndësishëm i ndajfoljeve me *-isht* është dhe ai që lidhet me emërtimin e gjuhëve a të dialektit ose së folmes së një populli, p.sh. *turqisht, arbërisht, toskërisht, rumanisht, gegërisht, sllavisht, italisht, gjermanisht, rumanisht, frëngjisht, persisht, arabisht.* Këtë grup e gjejmë kryesisht në shpjegime.

Prapashtesa *-thi*

Këtu mund të thuhet me më shumë siguri që ka rritje progresive të numrit të ndajfoljeve ndër fjalorët e shqipes (te “Fjalori ...” i K. Kristoforidhit 31 njësi – 5%; te “Fjalori i gjuhës shqipe” 68 njësi – 6%; te “Fjalori i gjuhës së sotme

⁶ J. Thomai, “Rreth ndajfoljeve me prapashtesën *-isht* në gjuhën e sotme shqipe”, *Studime për gjuhën shqipe, III, Semantika leksikore*, f. 235

shqipe” 118 njësi – 6%)⁷, ndërsa janë rreth 54 të tilla te “Fjalori” i Xhuvanit.

Xhuvani dhe Çabej dallojnë katër lloj ndajfoljesh me prapashtesën *-thi*, e cila bashkohet:

1. me emra të parmë, p.sh.: *cingëthi, qirithi, topti, vrap(ë)thi, ciqthi, fytythi* etj.

2. me emra jo të parmë, p.sh. *kapërcimthi, kërcimthi, peshimthi* etj.

3. me ndajfolje, p.sh.: *atëherthi, mbrëmthin, prëmthin, qetathi, qetëthi, qëparthi, tanithi, tashtithi* etj.

4. me kompozita të formuara prej dy emrash ose prej një emri dhe një elementi foljor, p.sh.: *cinga-pekthi, çalapatthi, gurapekthi, pulangrethi, symbyllthi* etj.

5. me folje, p.sh.: *për së kithi (kij)*.

Për shembull: SHKARTHI *ndajf.* Për së kithi, kërthazi, kitaz, shkarazi, rrëshqitas, për rrshit, kitaz; *gr. γοῦχος*; edhe *për së shkarthi, për së shqari*; sh. edhe FGjSh, f. 525.

Nisur nga pikëpamja kuptimore, një pjesë e këtyre ndajfoljeve emërtojnë mënyrën e kryerjes së lojërave të ndryshme, p.sh.: *cinga-pekthi, cingëthi, ciqthi, gurapekthi, gokthi, topti* etj.

Në disa raste kjo prapashtesë del me variantin *-thin*, p.sh.: PRËMTHIN [**prëmthinaj**] *ndajf.* Prëmë.

Në ndonjë rast del në variantin *-thinaj*, p.sh.: PASTAJTHINAJ *ndajf.* Pastaj, pastajthi; sh. edhe *pastajnaj, pastajmënaj*.

Prapashtesa -shëm

Një tip i përhapur është dhe ai i ndajfoljeve me *-shëm*, i trajtuar gjerësisht nga prof. J. Thomai⁸. Struktura formale e këtyre ndajfoljeve është e qartë. Tipi i formimit të këtyre ndajfoljeve është gjithashtu i qartë: Ato vijnë, siç është thënë, kryesisht prej mbiemrash (të formuar me prapashtesën *-shëm*), nëpërmjet “çnyjëzimit” të tyre.

⁷ J. Thomai, “Ndajfoljet me prapashtesën *-thi* në gjuhën shqipe”, *Studime gjuhësore, III, Semantika leksikore*, Tiranë, 2017, f. 173.

⁸ J. Thomai, “Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesën *-shëm* në gjuhën shqipe”, *Studime filologjike*, 1989/3, f. 55-72.

A. Xhuvani këto ndajfolje i përkufizon “ndajfolje prej mbiemrash tue ua hjekë nyjen; ... (i-e-të) *gëzueshëm, gëzueshëm, (i-e-të) kuptueshëm, kuptueshëm* etj.; pra: flas *kuptueshëm, rroj hollshëm, jam meshëm* (për ndonji gja), eci *thekatueshëm* etj.”⁹.

Ligjërimet popullore janë burimi i parë e kryesor i këtij grupi ndajfoljesh për gjuhën e sotme letrare. Kjo e ka përvetësuar tashmë nga ligjërimet e krijimtaria gojore popullore një numër të madh ndajfoljesh me *-shëm*. “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980) ka përfshirë 54 ndajfolje të tilla, përkundrejt 2 që ka “Fjalori i gjuhës shqipe” i K. Kristoforidhit (1904) dhe 21 që ka “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954)¹⁰. “Fjalori” i Xhuvanit ka 37 të tilla.

Nga pikëpamja tematike (e temës bazë, e cila është mbartëse edhe e temës semantike), më të pasura janë këto nëngrupe:

a) Me temë foljore (nga pjesorja, pjesorja e shkurtuar ose e tashmja): *agjinueshëm, frikshëm, lodhshëm, pritueshëm, rrjedhshëm, tremshëm, shtrëngueshëm, ngishëm, mendueshëm*.

b) Me temë emërore: *andshëm, nevojshëm, gjumshëm, njerëzishëm, zyrshëm*.

c) Me temë mbiemërore e ndajfoljore, p.sh.: *hollshëm, leshëm, lirshëm*.

Një tjetër prapashtesë që ndeshet në “Fjalor” është edhe *-(a)sh/ -(e)sh*. Sipas prof. E. Hysës kjo prapashtesë “vjen nga shndërrimi i morfemës trajtëformuese të rrjedhores në prapashtesë ...”¹¹. Gjejmë rreth 14 lema të formuara me të: *anash, copash, dysash, huazash, kulmash, mbyllasyzash, ndërdyshash, ndorash, ngojash, ngojesh, njitash, përgjysash, përthijash, turash*.

Ndajfolje të formuar me prapashtesën *-çë* nuk hasen te “Fjalori” i Xhuvanit.

⁹ A. Xhuvani, *Vepra I*, 1980, f. 239.

¹⁰ J. Thomai, “Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesën *-shëm* në gjuhën shqipe”, *Studime filologjike*, 1989/3, f. 55-72.

¹¹ E. Hysa, *Gramatikë e gjuhës shqipe, I, Morfologjia*, f. 376.

Xhuvani dhe Çabej njohin dhe prapashtesën *-na*¹², që nuk është shumë produktive, të cilën e quajnë më shumë një rrokje mbështetëse për formimin e ndajfoljeve, p.sh.:

GJITH-ASAJTËNA *ndajf.* Kudo, *it.* dovunque.

KOTNA *ndajf.* Kot, *khs.* kotnasikoti.

NDROSNA *ndajf.* Ndoshta (arbërisht).

Shumë herë Xhuvani e jep si është e formuar fjala që shërben si temë fjalëformuese, në rastet e ndërrimit të kategorisë leksiko-gramatikore (konversioni), emër-ndajfolje.

RRAZGAQ, -I *m.* Njeri që zë rrënjë më ndonjë vend dhe nuk ngrihet; *stobol.* ● Edhe si *mb.* ● Edhe si *ndajf.*: *Më ngeli a mbeti këtu rrazgaq* (Elbasan) na ka zënë derën, na mbeti këtu nga **rr* + *zgëq* (ai që rri në *zgëq* e nuk luan vendit): *khs.* *zgja-ni.*

ndajfolje-ndajfolje: CNELTHI *ndajf.*: (Cordignano) *Kërcen cnelthi* së larti, nga: *së nelt(i) + th.*

MAHERTHI *ndajf.* Atëhere; *m'at'her* (ë) + *thi* (Shpat).

Xhuvani shumë herë fjalët e përdorimit të përditshëm nuk jep, ose dhe kur i jep, nuk i shpjegon, por jep përdorimin e ndryshëm të tyre, p.sh.

GJALLË *ndajf.* 1. *Mbaj gjallë hovin e punës; të eci ngadalë s'mund sos gjallë* (kurrë); *s'rroj gjallë; mos u ndiej gjallë; të vijsh gjallë vdekë pa tjetër; e vrau me cakorren dhe e la pikë gjallë, të tre ranë pikë gjallë njeni mbas tjetrit.* 2. *Nuk zihet gjallë mishi, nuk ngrofet gjallë ma kjo gjellë; nuk po më ngrofen gjallë kambët; nuk u ftof gjallë kjo ma; nuk u mbarueka gjallë, s'mbarohet gjallë, s'byret gjallë ky bar.* 3. Tërë, musi, thjesht si, *gr.* ὀμοιος: *gjallë i jati* (nga fytyra dhe nga trupi); *gjallë i ungji* (nga tiparet); *gjallë e ëma* (nga të ecurit) (Myzeqe); *flet gjallë i jati; nuk hangre gjallë ti mâ dy sahat.*

KESH *ndajf.* (Kosovë) Sikur, *kinsë: kujtoj kesh* është sikur është; *kesh janë sikur janë; po i ban zâ ujkut kesh se ktheva* (Kurti, I, f. 31); *çohet njeni kesh se po tham dishka* (ibid., f. 36); *ja nis Marashi me gërhatë kesh se e ka kapë gjumi* (ibid., f. 55); *langun e derdh në gji kesh e piva* (ibid., f. 57); *kesh të shkojte im vlla në shkollë!; kesh të na dilte moti!;*

¹² A. Xhuvani, *vep. cit.*, f. 518.

baj kesh se po qaj; langun e derdh në gj, kesh e piva (Kati 57); e kapin e venë në shtrat kesh se ash tuj fjetë (57); kujton Muja kesh â fjet (270); rubën n'fyt Halilit ja ka qit kesh (gjoja) në gjum djali â ra (f. 53).

Në fjalori i gjejmë të gjitha klasat e fjalëve dhe ndajfolja zë mbi rreth 6 % të gjithë fjalësit. Mjafton dhe një paraqitje e tillë informuese për të treguar se puna e Aleksandër Xhuvanit për grumbullimin e fjalës shqipe ka qenë e kujdesshme, e saktë në regjistrime, por dhe sistemore. Në të ardhmen do të bëjmë objekt studimi dhe ndajfoljet që përdoren në shpjegime dhe në ilustrime, duke sjellë të plotë grupin e ndajfoljeve në këtë vepër të rëndësishme leksikografike.

BIBLIOGRAFI

- Hysa, E., “Formime ndajfoljore me prapashtesa në shqipen e sotme letrare”, *Studime filologjike*, 1970/1.
- Hysa, E., “Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe”, *Studime filologjike*, 1970/3.
- Hysa, E., *Gramatikë e gjuhës shqipe, I, Morfologjia*.
- Thomai, J., “Ndajfoljet me prapashtesën *-as/-azi* në gjuhën shqipe”, *Studime për gjuhën shqipe, III, Semantika leksikore*.
- Thomai, J., “Ndajfoljet me prapashtesën *-thi* në gjuhën shqipe”, *Studime gjuhësore, III, Semantika leksikore*, Tiranë, 2017.
- Thomai, J., “Rreth ndajfoljeve me prapashtesën *-isht* në gjuhën e sotme shqipe”, *Studime për gjuhën shqipe, III, Semantika leksikore*.
- Thomai, J., “Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesën *-shëm* në gjuhën shqipe”, *Studime filologjike*, 1989/3, f. 55-72.
- Xhuvani, A., *Fjalori i gjuhës shqipe*, përgatiti për botim Engjëllushe Karaj, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2020.
- Xhuvani, A., *Vepra I*, 1980.